

BASHKIA POGRADEC
NJOFTIM PËR DHËNIE ME QIRA

AUTORITETI QË ZHVILLON PROCEDURËN: Dhënien me qira, me konkurrim të sipërfaqeve me vendndodhje ne fshatin Blacë Çërravë, për kryerjen e operacioneve të kërkim-zbulimit hidrokarbure, gjeologjike e minerare, uji, vendosje objektesh të ndryshme ndihmëse Bashkia Pogradec, me adresë Lagja nr.2, Bulevardi "Reshit Çollaku", Tel: 083222222, email: bashkiapogradec@gmail.com.

Në mbështetje të; pikës 2 të nenit 8, nenit 64 të Ligjit Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, Ligjit Nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", Kreun VI të Ligjit Nr.7850, datë 29.7.1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, Ligjit Nr.8744, datë 22.02.2001 "Për transferimin e pronave te paluajtshme publike te shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", te ndryshuar, VKM – Nr.559, dt.29.07.2022 “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në përdorim të fondit pyjor kombëtar për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore”. Vendimit të këshillit të Ministrave Nr.433 dt.08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e t ëish Komunave dhe bashkive” të ndryshuar me vendimin nr.398 dt.13.05.2020, , te ndryshuar, Udhezimit Nr.13, datë 26.04.2018, te ndryshuar, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, të Vendimit të Keshillit te Ministrave Nr.54, datë 5.2.2014 "Per percaktimin e kriterëve, te procedures dhe te menyres se dhenies me qira, enfiteoze apo kontrata te tjera te pasurise shtetërore" si dhe në zbatim të Vendimit të Këshillit të Bashkisë Pogradec Nr.79, datë 28.07.2025, “Per miratimin në parim të dhënies me qira, në favor te individeve kërkues për kryerjen e operacioneve të kërkim-zbulimit hidrokarbure, gjeologjike e minerare, uji, vendosje objektesh të ndryshme ndihmëse në sipërfaqe, të pasurisë me sipërfaqe totale 40000 m2 (dyzet mijë) m2.”, dhe shkreses nr.703/1.prot date.08.08.2025 te Prefektit të Qarkut Korçe që konfirmon bazueshmërinë ligjore te tij, si dhe dokumentacionit të marrë nga ASHK Pogradec, po Ju dergon per botim ne buletin njoftimin me permbajtje si më poshtë:

1. Bashkia Pogradec njofton, fillimin e procedurave për dhënien me qira, me konkurrim në favor te individeve kërkues për kryerjen e operacioneve të kërkim-zbulimit hidrokarbure, gjeologjike e minerare, uji, vendosje objektesh të ndryshme ndihmëse në sipërfaqe, të pasurisë me sipërfaqe totale 40000 m2 (dyzet mijë) m2”, të detajuar si më poshtë:

Nr	Z.K	Pasuria	Vëndodhja	Siperf në m2	Objekti kerkeses
1	1208	34/1	Blacë, Çërravë	40000	Për kryerjen e operacioneve të kërkim-zbulimit hidrokarbure, gjeologjike e minerare, uji, vendosje objektesh të ndryshme ndihmëse në sipërfaqe

2. Vlera fillestare e fillimit të procedures konkurruese per dhenien me qera te pasurise te mesiperme sipas Raportit Teknik nr 4394/1 prot date 04.12.2025 eshte 312.000 (Treqind e dymbedhjete mije) Leke

3. Shoqëria/shoqëritë kontraktuese të përdorin pasuritë e mësipërme për ushtrimin e aktivitetit Për kryerjen e operacioneve të kërkim-zbulimit hidrokarbure, gjeologjike e minerare, uji, vendosje objektesh të ndryshme ndihmëse.

4. Afati maksimal i dhënies me qira të kësaj pasurie është 10 (Dhjete) vjet.

5. Vlerësimi i ofertave të konkurrentëve do të bëhet me pikët si vijon:

- a) Investimi 40 pikë
- b) Punësimi 40 pikë
- c) Tarifa mujore e qirasë 20 pikë

6. Konkurrimi do të zhvillohet më datë 30.12.2025, në orën 10:00, në Institucionin e Bashkise Pogradec. Ofertat dhe dokumentacioni perkates do te dorezohet me zarf te mbyllur, te patejdukshem, ne menyre zyrate me poste ose dorazi ne vendi dhe ora e percaktuar per daten e konkurrimit.

7. Në ngarkim të "Qiramarrësit" janë të gjitha tatimet dhe detyrimet që rëndojnë, mbi pronën e dhënë me qira sipas legjislacionit në fuqi.

8. Qiramarrësi duhet të ushtrojë aktivitetin në përputhje me detyrimet ligjore që rrjedhin, nga legjislacioni shqiptar për mjedisin dhe konventat ndërkombëtare për mjedisin në të cilat aderon Republika e Shqipërisë.

9. Konkurrentët do të paraqesin dokumentacionin si vijon:

- a) Kërkesën e subjektit për marrjen me qira të objektit.
- b) Plan biznesin, i vulosur dhe i firmosur në çdo faqe, ku të përshkruhet qartë qëllimi i përdorimit, aktiviteti që do të zhvillohet, plani i investimeve, vlera e investimeve, zërat dhe fazat e zhvillimit të tyre, plani i punësimit, periudha e realizimit të tyre, burimin e financimit.
- c) Ofertën për detyrimin vjetor të qirasë.
- d) Ekstraktin e regjistrimit të subjektit të lëshuar nga QKB.
- e) Ekstraktin historik të regjistrimit të subjektit të lëshuar nga QKB.
- f) NIPT-in e subjektit.
- g) Vërtetim nga Dega e Tatimeve për shlyerjen e detyrimeve tatimore dhe sigurimeve shoqërore.
- h) Vërtetim nga institucionet përkatëse se subjekti nuk është në ndjekje penale dhe nuk ka proces gjyqësor që lidhet me veprimtarinë që ushtron.
- i) Në rastet kur, subjekti konkurrues zhvillon aktivitet me qira në objekte pronë shtetërore, të paraqesë vërtetim nga institucioni që administron pronën për shlyerje të detyrimeve, në të kundërt të paraqesë deklaratë me shkrim se nuk ushtron aktivitet në objekte shtetërore.
- j) Deklarate se mban përgjegjësi ligjore për vertetesine e deklarimeve ne dokumentacionin e dorezuar ne konkurrim. Ne rast konstatimi te te dhenave te rreme, ne cdo rast, Komisioni e Skualifikon subjektin Konkurses.
- k) Raport paraprak te vleresimit ndikimit ne mjedis per veprimtarine qe do zhvillohet

I gjithë dokumentacioni, nuk duhet të jetë lëshuar, jo më para se 3 muaj nga dita e hapjes së ankandit. Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre.

Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të remë e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.